



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Gjiçanit
Opština Gnjilane
Municipal Gjiçan
Gilan Belediyesi

Në bazë të nenit 11, paragrafi 1, 2, nënparagrafi 2.1, 2.2 dhe 2.3, paragrafi 3 dhe 4 i Ligjit nr.04/L-144 Për Dhënie në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, i dt.22 Nëntor 2012, nenit 38, paragrafi 1, nënparagrafi 1.3 i Statutit të Komunës së Gjiçanit, për qëllimin e sigurimit të tokës për interes publik- rrugës publike (Rruga Qarkore) sipas PRRU “Fidanishte”, pas Rekomandimit të Komitetit për Pronë dhe Komitetit për Politikë dhe Financa, për këmbimin e pronës komunale me pronën private, Kuvendi i Komunës së Gjiçanit, në seancën e mbajtur me date 27.04.2016, miraton këtë :

V E N D I M

Për lejin e këmbimit të pronës së paluajtshme komunale me pronën e paluajtshme private për nevoja të Rrugës Qarkore sipas PRRU “FIDANISHTE” – Gjiçan

1. Kuvendi i Komunës Aprovon propozimin e Kryetarit të Komunës për këmbimin e pronës komunale me pronën private për nevoja të sigurimit të tokës për interes publik- Rrugës Qarkore të paraparë me PRRU “Fidanishte”, Zona Kadastrale Gjiçan.
2. Lejohet këmbimi i ngastrave kadastrale:
 - a) P-70403013-01987-8, lloji i njësisë-parcelë, zona-urbane, me sipërfaqe prej 369 m², te vendi i quajtur “Drenak”, lloji i shfrytëzimit – infrastrukturë, shfrytëzimi aktual i parcelës – rrugë, e cila evidentohet në emër të pronarit Rifat (Arif) Pajaziti, me 1/1 të pjesës së pronës, ZK-Gjiçan;
 - b) Me pjesët e ngastrave kadastrale :
 - P-70403013-00585-0, lloji i njësisë-parcelë, zona-urbane, lloji i pronës- prone shoqërore, me sipërfaqe prej 1593 m², te vendi i quajtur “Përroi i livadhit”, lloji i shfrytëzimit – rajon ujor, e cila evidentohet në emër të pronarit P.Sh.Kuvendi i Komunës -Gjiçan, me 1/1 të pjesës së pronës, ZK-Gjiçan; si dhe
 - P-70403013-00583-8, lloji i njësisë-parcelë, zona-urbane, lloji i pronës- prone shoqërore, me sipërfaqe prej 1804 m², te vendi i quajtur “Dobrusha”, lloji i shfrytëzimit – bujqësore, e cila evidentohet në emër të pronarit P.Sh.Kuvendi i Komunës -Gjiçan, me 1/1 të pjesës së pronës, ZK-Gjiçan.
3. Pronat e përshkruara në pikën II të këtij Vendimi janë të përfshira me Planet Rregulluese Urbane “Fidanishte” dhe “Petigoc” dhe këmbimi i këtyre pronave bëhet në përputhje me këto plane, sipas destinimit të paraparë .

4. Obligohet Kryetari i Komunës, që pas plotëfuqishmërisë së këtij Vendimi të bëjë kërkesë Ministrisë për Financa-ZVPP për vlerësimin e pronave të paluajtshme të cilat janë objekt i këmbimit dhe të lidhin Kontratë për këmbimin me pronarin privat të cekur në nenin II të këtij vendimi duke u bazuar në raportet e vlerësimit nga Ministria përkatëse.
5. Obligohet Drejtoria për Gjeodezi, Kadaster dhe Pronë që pas hyrjes në fuqi të këtij vendimi të bënë parcelimin e ngastrës Komunale sipas raportit të vlerësimit dhe pas lidhjes së kontrates mes Kryetarit të Komunës dhe pronarit privat të bënë regjistrimin e pronave të këmbyerë në Regjistrat Kadastral.
6. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Kryetari i Komunës së Gjilanit, Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit, Drejtoria për Gjeodezi, Kadaster dhe Pronë e KK-Gjilan, ndërsa për monitorim të zbatimit kujdeset Kryesuesi i Kuvendit Komunal Gjilan.
7. Ky Vendim hynë në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të MAPL-së dhe publikimit në gjuhët zyrtare në uebfaqen e Komunës.

01.Nr. 016-39501
Gjilan, më 27.04.2016

Kuvendi i Komunës

/Valentina Bunjaku –Rexhepi/